



Pranuar / Dorezuar Primitjen/Prodato Received/Delivery	15.11.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jodinicat Org./Unit	Nr Prot tit Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHUK	7146/2022		1/5



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.803/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arditë Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Arditë Perçuku-Shyti -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.803/2022 të datës 19.09.2022, të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë [redacted] kundër organit të punësimit/Zyra e Kryeministrit, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 15.11.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.803/2022 e datës 19.09.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

### A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] është e punësuar në Zyrën e Kryeministrit, sipas Akt emërimit me numër Nr.prot.111/2019 të datës 08.02.2019 në pozitën “Koordinatorë e zyrës për çështje të komuniteteve” në Zyrën për çështje të komuniteteve. Drejtori i Zyrës për Çështje të Komuniteteve, me datën 27.12.2017 ka parashtruar kërkesë tek Shefi i kabinetit të Kryeministrit, lidhur me atë që për zyrtaret e ZÇK-së të ndahen shtesat në vlerën prej dyqind (200) euro në muaj, për shkak të mbingarkesës në punë. Ndërsa me datën 10.01.2018, Kryeministri i Republikës së Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.297/2018, sipas të cilit janë ndarë mjetet buxhetore në vlerën prej 9600 (nëntëmijë e gjashtëqind) euro nga Zyra për Çështje të Komuniteteve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit për zyrtarët e këtij digasteri.

Me datën 18.08.2022, ankuesja ka parashtruar kërkesën me numër protokolli 1954, tek zëvendës Sekretari i Zyrës së Kryeministrit, lidhur me zbatimin e vendimit për shtesa, pasi që sipas saj shtesa

në shumën prej dyqind (200) eurove i është ndaluar pa asnjë njoftim paraprak si dhe se vendimi lidhur me realizimin e shtesës për shumën e dyqind (200) eurove nuk është shfuqizuar.

E pakënaqur me mos zbatimin e vendimit lidhur me realizimin e shtesës në shumën prej dyqind (200 eurove) nga ana e Zyrës së Kryeministrit, me datën 19.09.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 5475/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me ndërprerjen e kësaj shtese pa asnjë njoftim paraprak me shkrim se vendimi lidhur me njohjen e kësaj shume është ndryshuar apo shfuqizuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 23.09.2022, ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 5623/2022 për përgjigje në ankesë tek Zyra e Kryeministrit, ndërsa me datën 27.09.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion së bashku me provat e lëndës.

Me datën 31.10.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr.136/2022 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritor ka administruar këto prova:** Vendimin e lëshuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me nr.protokolli 6592/2022 të datës 31.10.2022; Ankesën e parashtruar nga me nr.protokolli 5475/2022 të datës 19.09.2022; Kërkesën për zbatimin e vendimit për shtesa me nr.protokolli 1954 të datës 18.08.2022; Vendimin e lëshuar nga Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr.protokolli 1854/2018 të datës 11.12.2018; Kërkesën nga Zyra për Çështje të Komunitetit të Republikës së Kosovës të datës 10.12.2018; Kërkesën për përgjigje në ankesë me nr.protokolli 5623/2022 të datës 23.09.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë me nr.protokolli 5701/2022 të datës 27.09.2022; Akt Emërimit të lëshuar nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës me nr.protokolli 111/2019 të datës 08.02.2019 të ankueses; Përshkrimin e detyrave të punës të vitit 2019; Vlerësimin e vendeve të punës të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike - Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës me nr.protokolli 3648 të datës 21.11.2018; Kërkesën për zbatimin e vendimit për shtesa të parashtruar nga ankuesja me nr.protokolli 1954 të datës 18.08.2022; Përgjigje në kërkesë të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës me nr.protokolli 1954 të datës 21.09.2022; Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZKM-së të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës me nr.protokolli 1451 të datës 14.08.2020; Menaxhimi i Zyrës së Kryeministrit - Plani i veprimit të menaxhmentit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Auditimit; Kërkesën e parashtruar nga Zyra për çështje të Komuniteteve të Republikës së Kosovës të datës 10.12.2018; Vendimin e lëshuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës me nr.protokolli 297/2018 të datës 10.01.2018; Kërkesën e parashtruar nga Zyra për Çështje të Komuniteteve të Republikës së Kosovës të datës 27.12.2017; Përgjigjen në Kërkesën me nr.protokolli 1954 të datës 19.09.2022 të lëshuar nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Urdhër Obligimin për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104180296 të datës 09.02.2018; Urdhër Obligimin për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104180511 të datës 21.08.2018; Urdhër Obligimi për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me

nr.reference 104180711 të datës 11.05.2018; Urdhër Obligimi për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104181148 të datës 24.04.2018; Urdhër Obligimi për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104181883 të datës 31.05.2018; Urdhër Obligimi për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104181801 të datës 05.07.2018; Urdhër Obligimi për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104182203 të datës 08.08.2018; Urdhër Obligimi për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104182347 të datës 24.04.2018; Urdhër Obligimi për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104182728 të datës 25.09.2018; Urdhër Obligimi për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104182959 të datës 25.10.2018; Urdhër Obligimi për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104183436 të datës 26.11.2018; Urdhër Obligimi për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104183440 të datës 19.12.2018; Urdhër Obligimi për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104190609 të datës 06.03.2019; Urdhër Obligimi për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104190914 të datës 27.03.2019; Urdhër Obligimi për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104190917 të datës 27.03.2019; Urdhër Obligimi për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104191519 të datës 15.05.2019; Urdhër Obligimin për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104191717 të datës 29.05.2019; Urdhër Obligimin për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104192120 të datës 27.06.2019; Urdhër Obligimin për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104192463 të datës 08.08.2019; Urdhër Obligimi për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104193426 të datës 23.10.2019; Urdhër Obligimin për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104193427 të datës 26.10.2019; Urdhër Obligimin për Pagesë të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës me nr.reference 104193428 të datës 28.10.2019 dhe Vendimin VK.nr.136/2022 te datës 31.10.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për prova shtesë përmes e-mailit zyrtar te datës 15.11.2022 nga KPMSHCK; Përgjigjen ne informata zyrtare përmes e-mailit zyrtar te datës 15.11.2022 nga Zyra e Kryeministrit te Republikës se Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se është e pabazuar ankesa e parashtruar nga ankuesja

*sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht dispozitat e nenit 19, ku përcaktohet se: *"Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e pagave"*, ka konstatuar se ankuesja në bazë të Vendimit Nr.Prot.1854/2018 të datës 11.12.2018 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ka realizuar shtesën në vlerën prej dyqind (200) euro në muaj, shtesë kjo e miratuar duke u bazuar në kërkesën me numër reference 128/2017 të datës 27.12.2017, e Drejtorit të Zyrës për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, me arsyetimin se zyra për çështje

të komuniteteve në vazhdimësi ka volum të madh të punëve dhe numër të vogël të stafit si dhe për shkak të mbingarkesës në punë të stafit të kësaj zyre. Kolegji pas vlerësimit të situatës juridike lidhur me ankesën e ankueses, ka analizuar dispozitat e nenit 20 paragrafit 1 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil në të cilin përcaktohet se: *"1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës në këto raste: 1.1. kompensim për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës; 1.2. kompensim për punë jashtë orarit gjatë fundjavës dhe 1.3. kompensim për punë jashtë orarit gjatë festave zyrtare; 1.4. kompensim për pushim vjetor; 1.5. kompensim për kohën e paaftësisë së vërtetuar të përkohshme për shkak të sëmundjes; 1.6. kompensim gjatë shtatzënisë dhe lehonisë; 1.7. kompensim në rast të shfrytëzimit të pushimit të veçantë me pagesë; 1.8. kompensim në rast të perfeksionimit profesional të specializuar për nevojat e organit ose të shtetit"* dhe ka konstatuar se tek rasti i ankueses nuk është përmbushur asnjëri nga kushtet e mësipërme lidhur me përfitimin-kompensimin e shtesave në pagë, siç parashihen me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me përfitimin e shtesës nga ankuesja në vlerën prej dyqind (200) eurove sipas Vendimit Nr.Prot.1854/2018 të datës 11.12.2018 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ka analizuar po ashtu edhe dispozitat e nenit 21 paragrafit 2 të Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, në të cilin përcaktohet se: *" 2. Nëpunësit civilë, për punë jashtë orarit, kanë të drejtë të marrin kompensim me pagesë ose kohë të lirë nëse: 2.1. mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ka autorizuar paraprakisht me shkrim numrin e orëve të punës jashtë orarit; 2.2. mëditje për udhëtim jashtë vendit; 2.3. pas plotësimit të këtyre orëve, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë vërteton me shkrim orët faktike të plotësuara"*, ndërsa Rregullorja Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime Tjera të Nëpunësve Civil konkretisht neni 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1. 1.2. 1.3. 1.4. 1.5. përcakton se: *1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë të kompensohen në këto raste: 1.1 për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës; 1.2 për punën jashtë orarit gjatë fundjavës; 1.3. për punën jashtë orarit gjatë festave zyrtare; 1.4. për kohën e pushimit vjetor; 1.5. për kohën e paaftësisë së vërtetuar të përkohshme për shkak të sëmundjes"* dhe ka konstatuar se ankuesja pagesën në vlerën e shtesës prej dyqind (200) eurove e ka pranuar në bazë të urdhër obligimit për pagesë nga kodi buxhetor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve-kategoria e mallrave dhe shërbimeve, e jo sikurse në format të cilat i parashih legjislacioni në fuqi përmes formularëve për orët shtesë të cilat i plotëson nëpunësi bazuar në autorizimin paraprak të udhëheqësit të drejtpërdrejtë. Andaj mbi bazën e lartcekur, Kolegji ka konstatuar se forma e realizimit të kësaj shtese nga ana e ankueses, nuk ka bazë ligjore siç e përcakton Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe Rregullorja Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime Tjera të Nëpunësve Civil.

Nga administrimi i shkresave të lëndës e bazuar në Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës me numër Ref:112/2020 të datës 14.08.2020, rezulton se sipas Raportit final Nr.Prot.660/4 të datës 10.07.2020 të auditimit të brendshëm për Menaxhimin e Zyrës së Kryeministrit për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2019, tek e gjetura 3.5.2 është theksuar fakti lidhur me pagesat shtesë të nëpunësve civil jo në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi dhe ka konstatuar që: *"pagesat shtesë të nëpunësve të rregullt nga mallrat dhe shërbimet, gjatë orarit të punës janë në kundërshtim me nenin 80 të Ligjit Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë"*. Ndërlidhur me këtë situatë, neni 19 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ka përcaktuar se: *"Institucionet e administratës publike çdo vit, së bashku me kërkesën vjetore për buxhet, dorëzojnë në ministrinë përgjegjëse për financa shumë e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve për shtesat mbi pagën bazë në institucionin përkatës. 2. Institucionet e administratës publike çdo vit mund t'i paguajnë shtesa stafit të tyre vetëm me kusht që shumat e përgjithshme e shtesave dhe pagave bazë*

të jetë përcaktuar nga ministria përgjegjëse për financa, brenda llogarisë së përgjithshme të përcaktuara për institucionin përkatës”, rrjedhimisht sipas kësaj del se edhe gjatë raportit të auditimit të lartcekur tek e gjetura 3.2.1 po ashtu është theksuar fakti se: “ shpenzimet e përsëritura gjatë vitit duhet të jenë pjesë e planifikimeve për shpenzime vjetore...”, andaj nisur nga ky fakt Kolegji vlerëson se Zyra e Kryeministrit konkretisht Zyra për Çështje të Komuniteteve, nuk ka ofruar prova të mjaftueshme lidhur me planifikimin vjetor të buxhetit për këtë kategori të shtesave të cilën e ka realizuar ankuesja, andaj edhe pretendimet ankimore të ankueses për kompensimin e kësaj shtese janë të pabazuara dhe nuk janë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 si dhe dhe nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.803/2022, datë 15.11.2022

Ardita Percuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.